



Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 25 pika 4 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.01.2018, bie këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT PËR VITIN 2018

Neni 1.

Aprovohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Deçanit për vitin 2018, si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Janar	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2018, 2. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2018, 3. Marrja e Vendimit për inicimin e procedurave për hartimin (revidimin) e Planit Zhvillimorë Komunal, 4. Marrja e Vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës, 5. Marrja e Vendimit për këmbimin e pronës Komunale-ngastra 429 me pronën private të personit fizik, 6. Formimi i Komitetit të Komuniteteve, 7. Formimi i komisionit për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës dhe Rregulloreve komunale, 8. Formimi i komisionit për emërim dhe riemërim të rrugëve , shesheve dhe lagjeve urbane, 9. Formimi i Këshillit për Siguri në Bashkësi,	
-------	--	--

	10. Formimi Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së palujtëshme të Komunës.	
Shkurt	1.Orientimi I të hyrave vetanake të bartura nga viti 2017 në vitin 2018. 2.Shqyrtimi I Projekt Statutit të Komunës, 3.Shqyrtimi I ndryshimeve dhe plotësimeve të Projeket Rregullores Për Lartësinë e Taksave ,Ngarkesave ,Tarifave dhe Gjobave Komunale,	
Mars	1.Shqyrtimi I raportit analitik financiar për vitin 2017.	
Prill	1.Shqyrtimi I raportit financiar për periudhën Janar- 31 Mars 2018.	
Maj	1. Trajtim I rregulloreve komunale me rekomandim të komisionit statutar.	
Qershor	1. Shqyrtimi I draftit të parë të Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2019-2021, 2. Shqyrtimi dhe aprovimi I Rishikimit të buxhetit për vitin 2018, 3. Mbledhja e I-rë Publike për vitin 2018.	Diskutim publik me qytetar Për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021.
Korrik	1.Raporti gjashtëmuor I Kryetarit të Komunës, 2.Raporti analitik gjashtëmuor financiar, 3.Marrja e Vendimit për pushim vjetor të anëtarëve të Kuvendit.	
Gusht	Pushim	

Shtator	1. Shqyrtimi dhe miratimi I Buxhetit për vitin 2019. 2. Shqyrtimi dhe miratimi I Rregullores mbi Tatimin në pronë për vitin 2019. 3. Njoftim nga Ekzekutivi mbi përgaditjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2018/2019.	
Tetor	1. Shqyrtimi I Raportit nëntë mujor financiar,	
Nëntor	1. Shqyrtimi I raportit të Auditorit të Jashtëm.	
Dhjetor	1. Shqyrtimi I Raportit vjetorë të Kryetarit të Komunës. 2. Mbledhja e II-të Publike për vitin 2018.	

Neni 2.

Kuvendi i Komunës përveq pikave të paraqitura nga neni 1. i këtij vendimi gjatë vitit 2018 do të shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës dhe kërkesës së Ekzekutivit të Komunës.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 4.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-3

Deçan, dt. 31.01.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

HYRESE-ULAZNA-INGOING
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEČANE • DEÇANI MUNICIPALITY

Nr. Prot. 3503
Br. Prot. Prot. No.
Data: 05.02.18
Dati: 05.02.18

Nr. I faqeve: 01
Br. Stranica: 01
No Pages: 01

DEÇAN, DEČANE



Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj